



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 25.08.2023
02 Nr.400/01-22401/23

PROCESVERBAL

Dëgjimi Buxhetor me banorët e fshatit Restelicë
I mbajtur më 25.08.2023, e premte, duke filluar nga ora 17:00
VENDI: Shkolla fillore e fshatit Restelicë

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 17.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Restelice.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Restelica.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 24.08.2023:

Shqip:<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=643784637850723&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=643785561183964&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
3. Behar Brenoli – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
4. Suad Tosuni – Zyra e Kuvendit, përkthyes
5. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 15 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 0
2. Meshkuj: 15

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komunale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjellësit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit. Me ardhjen në pushtet e kemi ritenderuar projektin e Ujësjellësit, pa ndryshime. Ky rrjet do të kushtojë afërsisht 2.5 milionë euro.

Kërkesat e qytetarëve

Murat Mushka, banor i fshatit Restelicë:

- Kemi probleme me tensionin e ulët të rrymës në fshatin Restelicë.

Berat Çufta, banor i fshatit Restelicë:

- Të intervenohet në rrugën 'Llokuv', sepse është shumë e ngushtë, rreth 3 metër. Ka një gjatësi afër 230 metër dhe aty janë ndërtuar 15 shtëpi të reja.

Nesim Hodza, Radio Bambus:

- Duhet të na ndihmoni të gjejmë një zgjidhje të përbashkët për çështjen e mbeturinave të ngurta.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë

